

PRISHTINË, QERSHOR 2021

# Integriteti akademik, publikimi shkencor dhe justifikimi i titujve akademikë në Universitetin e Gjilanit



UNIVERSITETIN  
E GJILANIT





INTEGRITETI  
AKADEMIK,  
PUBLIKIMI  
SHKENCOR DHE  
JUSTIFIKIMI  
I TITUJVE  
AKADEMIKË NË  
UNIVERSITETIN  
E GJILANIT

**Publikues:**

ORCA - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

[www.orca-ks.org](http://www.orca-ks.org)

[info@orca-ks.org](mailto:info@orca-ks.org)

Rruga Henrik Bariç, nr. 6  
Prishtina, 10000, Kosova

**Autor dhe hulumtues:**

Saranda Sylejmani

**Dizajn dhe Layout:**

Envinion

Prishtinë, qershor 2021



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë  
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.  
Falna durimin të thellojmë një punë përpara  
se të shkruajmë mbi të! Frymëzoha me një  
ndjenë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo  
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!  
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga  
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e  
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

# PËRMBAJTJA

DEFINIME .....	7
HYRJE .....	8
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË UNIVERSITETIT .....	9
Buxheti.....	9
Studentët.....	9
Transparenca formale .....	10
PASQYRA AKADEMIKE E UNIVERSITETIT TË GJILANIT .....	11
Numri i publikimeve shkencore në Universitetin e Gjilanit.....	11
Publikimi në revista të dyshimta .....	15
Justifikimi i titujve akademikë.....	17
KRAHASIMI ME UNIVERSITET E TJERA PUBLIKE .....	19
FAKULTETI JURIDIK .....	21
Publikimi shkencor .....	21
Justifikimi i titujve akademikë.....	22
FAKULTETI EKONOMIK.....	23
Publikimi Shkencor.....	23
Justifikimi i titujve akademikë.....	24
FAKULTETI I EDUKIMIT .....	25
Publikimi shkencor .....	25
Justifikimi i titujve akademikë.....	26
FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE.....	27
Publikimi Shkencor.....	27
Justifikimi i titujve akademikë.....	28
METODOLOGJIA.....	29
Baza ligjore.....	29
Objekti i shqyrtimit .....	30
Periudha e mbledhjes së materialit për hulumtim.....	30
Llogaritja e justifikimit të titujve akademik.....	30
Llogaritja e numrit të publikimeve shkencore.....	32

## DEFINIME

- **Punime të vlefshme për avancim** - konsiderohen punimet e publikuara në revista siç është përcaktuar me ligjet dhe rregullativat për emërim, riemërim dhe avancim të stafit akademik.
- **Punime shkencore** - punimet ku profesorët marrin pjesë si autorë pavarësisht renditjes, pra jo vetëm si autor i parë apo korrespondent.
- **Punime në revista të dyshimta** - punimet të cilat janë në revista apo në botues të listuar në listën Beall.
- **Justifikimi i titullit** - të pasurit e numrit të nevojshëm të publikimeve shkencore për titullin përkatës sipas ligjeve dhe rregullativave në fuqi.
- **Burra dhe gra** - Gjinia e presupozuar e personave në bazë të emrit pa paragjykuar identifikimin e tyre personal.

# HYRJE

Hulumtimi mbi integritetin akademik dhe publikimin shkencor në Universitetin e Gjilanit vjen si rrjedhojë e nevojës së publikut për t'u informuar rreth cilësisë së arsimit në universitete publike, të cilat kryesisht financohen nga taksapaguesit. Vlerësimi i cilësisë së arsimit në universitete publike dhe kritika racionale ndaj parregullsive eventuale në këto universitete, sipas ORCA-s ndikon në përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Për më tepër, ky hulumtim është vazhdimësi e hulumtimeve që ORCA realizon tash e sa vite për universitetet publike. Tashmë është publikuar raporti i hulumtimit mbi integritetin akademik dhe publikimin shkencor për Universitetin e Pejës, Universitetin e Prizrenit, Universitetin e Gjakovës, Universitetin e Mitrovicës, dhe Universitetin e Prishtinës. E gjithë kjo punë është bërë në kuadër të projektit QAIN. Periudha hulumtuese për këtë raport është realizuar gjatë muajit maj 2021, ku hulumtuesit e ORCA-s shqyrtuan materialet e publikuara në CV-të e stafit akademik të Universitetit të Gjilanit me titujt akademikë: profesor asistent dhe profesor i asocuar. Në Universitetin e Gjilanit është evidentuar që nuk ka staf akademik me titullin profesor i rregullt.

Nga gjithsej 5 fakultete sa ka Universiteti i Gjilanit, janë shqyrtuar CV-të e stafit akademik vetëm në 4 fakultete. Gjatë llogaritjeve statistikore është eliminuar Fakulteti i Shkencave Aplikative, meqë stafi akademik që figuron aty, është i angazhuar me punë të rregullt nëpër fakultete tjera të këtij universiteti. Pra, këta profesorë të Fakultetit të Shkencave Aplikative janë shqyrtuar brenda fakulteteve tjera të këtij universiteti.

Nga gjetjet e përgjithshme del se në Universitetin e Gjilanit janë të punësuar 40 profesorë me tituj akademikë dhe kontratë të rregullt prej të cilëve 8 (20%) janë gra dhe 32 (30%) burra. 65% e stafit akademik nuk i justifikojnë titujt e tyre. Prej tyre, 15% janë gra dhe 85% janë burra.

Numri total i publikimeve në Universitetin e Gjilanit është 57. Fakulteti me më së shumti punime në revista shkencore është Fakulteti Ekonomik, me gjithsej 25 të tilla, dhe me mesatare prej 1.79 punimesh për kokë profesori.

Kjo analizë mund të shërbej për planifikimin dhe buxhetimin e politikave relevante që financojnë zhvillimin e projekteve shkencore brenda Universitetit të Gjilanit, në mënyrë që të rritet numri i publikimeve shkencore të mirëfillta në këtë universitet.



# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

## BUXHETI

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Gjilanit, janë ndarë gjithsej 2 milionë e 363 mijë e 982 euro vetëm për vitin 2019, ndërsa për vitin 2020, janë ndarë 1 milionë e 947 mijë e 614 euro, sipas gjetjeve në raportin e fundit për financa të publikuar nga ORCA<sup>1</sup>, në tetor të vitit 2020.

## STUDENTËT

Nga të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës<sup>2</sup> rezulton se numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në nivel Bachelor në Universitetin e Gjilanit për vitin akademik 2020/2021 është 2350 studenta, përdërisa 747 janë meshkuj dhe 1603 janë femra. Numri i të diplomuarve në nivel Bachelor gjatë vitit akademik 2019/2020 është 336, prej të cilëve 88 janë meshkuj dhe 248 janë femra.

Sa i përket numrit të studentave që janë duke studiuar në nivel Master në Universitetin e Gjilanit përgjatë vitit akademik 2020/2021, gjithsej janë 191 studenta, përkatësisht 94 meshkuj dhe 97 femra. Gjatë vitit 2019/2020, vetëm një student ka diplomuar në nivelin master në Universitetin e Gjilanit.

## TRANSPARENCA FORMALE

Nga hulumtimi i ORCA-s (vitit 2020) mbi transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike<sup>3</sup>, del se Universiteti i Gjilanit ka publikuar në uefaqen zyrtare 22 nga gjithsej 27 dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit. Rrjedhimisht, kjo tregon se transparenca dhe llogaridhënia në këtë universitet ka shënuar rritje nëse krahasohet me të gjeturat e vitin 2019<sup>4</sup>, kur universiteti kishte publikuar vetëm 20 dokumente publike.

1 Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës: Menaxhimi i Financave", 2020, linku:

<http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Menaxhimi-i-financave-2.pdf>

2 Statistikat e arsimit në Kosovë 2020/2021, qershor 2021, linku: <https://ask.rks-gov.net/media/6072/statistikat-e-arsimit-20202021.pdf>

3 Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës: (Mos)informimi i publikut", 2020, linku:

<http://orca-ks.org/ep-content/uploads/2020/10/Mosinformimi-i-Publikut-2.pdf>

4 Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës: (Mos)informimi i publikut", 2019, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

# PASQYRA AKADEMIKE E UNIVERSITETIT TË GJILANIT

Universiteti i Gjilanit ka 40 profesorë që janë evidentuar përmes CV-ve të publikuara në uebfaqen e universitetit dhe gjithsej 5 fakultete. Në këtë hulumtim janë paraqitur vetëm 4 fakultete të Universitetit të Gjilanit, për arsye se stafi akademik në Fakulteti i Shkencave Aplikative janë të listuar edhe në fakultetet tjera përkatëse të këtij universiteti. Për hir të nevojave të këtij hulumtimi, janë numëruar vetëm një herë. Nga 40 profesorë sa ka në total, 8 janë gra (20%) dhe 32 janë burra (80%). Në Universitetin e Gjilanit nuk ka profesorë të rregullt, përderisa 10 profesorë janë të asocuar dhe 30 profesorë asistentë.


## NUMRI I PUBLIKIMEVE SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E GJILANIT

Profesorët e Universitetit të Gjilanit gjithsej kanë publikuar 57 punime shkencore. Kjo e dhënë është gjeneruar nga CV-të e profesorëve të publikuara në uebfaqen e universitetit. Kurse numri i punimeve të vlefshme për avancim akademik është 53.

Nga gjithsej 40 profesorë, 21 apo 53% e tyre nuk kanë publikuar asnjë punim shkencor si autor i parë dhe korrespondent. Në vitin 2019, profesorët e këtij universiteti kanë publikuar më së shumti punime shkencore, 13 sosh apo 22% e totalit.

Është e rëndësishme të potencohet që, në të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2020 numri i profesorëve që nuk kanë publikuar asnjë punim shkencor në Universitetin e Mitrovicës është 23 apo 32%, në Universitetin e Gjakovës 14 apo 54%, ndërsa në Universitetin e Prishtinës 150 apo 29%. Ndërkohë që për vitin 2019, në Universitetin e Prizrenit ishin 31 apo 55% dhe në Universitetin e Pejës ishin 22 apo 66% profesorë që nuk kanë asnjë punim shkencor.

## PUBLIKIMI SHKENCOR NË UNIVERSITETIN E GJILANIT



Fakulteti Ekonomik evidentohet si fakulteti me më së shumti publikime shkencore në revista shkencore, me gjithsej 25 të tilla dhe mesatare 1.79 punime për kokë profesori.

Nga të dhënat e gjeneruara për vitin 2020, fakulteti me më së shumti punime shkencore në Universitetin e Gjakovës është Fakulteti i Mjekësisë, me 66 punime dhe mesatare 9.4 punime për kokë profesori.

Ndërkohë që fakulteti me më së paku punime të botuara në revista shkencore në Universitetin e Gjiatani është Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me 4 punime dhe mesatare prej 0.57 punime për kokë profesori.

## PUBLIKIMET SHKENCORE PËR PROFESOR

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Gjilanit	Numri total i publikimeve	Numri total i profesorëve	Punime për profesor
1	Fakulteti Ekonomik	25	14	1.79
2	Fakulteti i Edukimit	13	9	1.44
3	Fakulteti Juridik	15	10	1.5
4	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	4	7	0.57
<b>TOTAL</b>		<b>57</b>	<b>40</b>	<b>1.43</b>

Mesatarja e punimeve në nivel universiteti është 1.43 punime për profesor.

Për krahasim, në të dhënat e mbledhura për vitin 2020, në Universitetin e Gjakovës janë 3.65 punime për profesor, në Universitetin e Mitrovicës janë 3.61 punime për profesor, ndërsa në Universitetin e Prishtinës numri total i punimeve shkencore është 5 punime për profesor.

Nga të dhënat e mbledhura për vitin 2019, në Universitetin e Prizrenit ishin 1.17 punime për profesor. Ndërsa në Universitetin e Pejës numri i punimeve shkencore për kokë profesori ishte 0.70.

Të dhënat e gjeneruara nga hulumtimi, tregojnë se nga 40 profesorë sa ka Universiteti i Gjilanit, 21 apo 53% nuk kanë të botuar asnjë punim shkencor në revista shkencore. Fakultetet me më së shumti profesorë që nuk kanë të botuar asnjë punim, është Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, ku 86% e profesorëve nuk kanë asnjë punim shkencor.

Që të gjitha fakultetet e Universitetit të Gjilanit kanë raste me profesorë pa asnjë punim shkencor, mirëpo mesatarja më e ulët e rasteve të tilla shënohet në Fakultetin Ekonomik me 36% apo 5 profesorë.

Nr	Fakultetet në Universitetin e Gjilanit	Numri i profesorëve pa asnjë punim shkencor	Numri total i profesoreve
1	Fakulteti Ekonomik	5 (36%)	14
2	Fakulteti i Edukimit	4 (44%)	9
3	Fakulteti Juridik	6 (60%)	10
4	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	6 (86%)	7
<b>TOTAL</b>		<b>21 (53%)</b>	<b>40</b>

## PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

Nga gjithsej 40 profesorë të Universitetit të Gjilanit, 14 apo 35% kanë publikuar në revista të dyshimta. Numri i përgjithshëm i punimeve të tilla në nivel universiteti është 33. Fakulteti me më së shumti botime në revista të dyshimta cilësohet të jetë Fakulteti Ekonomik me gjithsej 10 punime.

Për krahasim, nga numri total i profesorëve, publikimi në revista të dyshimta në Universitetin e Gjakovës për vitin 2020 është 58%, përderisa në Universitetin e Mitrovicës përqindja e publikuesve është dukshëm më e lartë, më përkatësisht 78%. Për të njëjtin vit, në Universitetin e Prishtinës 38% e profesorëve kanë publikuar në revista të tilla.


Ndërkaq për vitin 2019, në Universitetin e Pejës 45% e profesorëve kanë publikuar në revista të dyshimta, kurse në Universitetin e Prizrenit kjo e dhënë ishte 66%.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Gjilanit	Numri i publikimeve në revista të dyshimta	Numri i profesorëve që publikuan në revista të dyshimta
1	Fakulteti Ekonomik	10	5
2	Fakulteti i Edukimit	9	4
3	Fakulteti Juridik	6	2
4	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	8	3
<b>TOTAL</b>		<b>33</b>	<b>14</b>

Profesorët e Universitetit të Gjilanit kanë publikuar në revista të dyshimta brenda një periudhe 7 vjeçare, më konkretisht nga viti 2013 deri në vitin 2019. Viti 2015 karakterizohet si viti me më së shumti publikime në revista të dyshimta, në total 10. Ndërkaq në vitet në vazhdim, numri i publikimeve në revista të dyshimta ka pësuar rënie, me 0 punime në vitin 2020 dhe 2021 deri tani.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA




## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Nga 40 profesorë në Universitetin e Gjilanit, 26 apo 65% nuk i justifikojnë titujt akademikë sipas kriterit të punimeve shkencore si autor i parë dhe korrespondent. Për krahasim, në vitin 2020, 65% e profesorëve të Universitetit të Gjakovës nuk i justifikojnë tituj akademikë, ndërsa mosjustifikimi i titujve akademikë në Universitetin e Mitrovicës është 48%, ndërsa për të njëjtën periudhë në Universitetin e Prishtinës 45% e profesorëve nuk i justifikojnë titujt akademikë.

Të dhënat e vitit 2019, tregojnë se 64% e profesorëve në Universitetin e Prizrenit nuk i justifikojnë titujt akademikë, dhe në Universitetin e Pejës mosjustifikimi i titujve nga stafi i rregullt akademikë ishte 70%.

Nga 30 profesorë asistentë, 20 apo 67% prej tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë, përderisa nga 10 profesorët e asocuar 6 apo 60% nuk i justifikojnë titujt akademikë. Universiteti i Gjilanit nuk numëron asnjë profesor të rregullt.

### JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË NË UNIVERSITETIN E GJILANIT





Fakulteti me më së shumti profesorë që nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë është Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me 86% të profesorëve, apo 6 nga 7 profesorë sa ka gjithsej. Kurse fakulteti me përqindjen më të ulët të mosjustifikimit të titujve akademikë, vlerësohet të jetë Fakulteti Ekonomik, ku 8 nga 14 profesorë nuk i justifikojnë titujt apo 57%.

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Gjilanit	Pozitiv	Negativ	TOTAL
1	Fakulteti Ekonomik	6 (43%)	8 (57%)	14
2	Fakulteti i Edukimit	3 (33%)	6 (67%)	9
3	Fakulteti Juridik	4 (40%)	6 (60%)	10
4	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	1 (14%)	6 (86%)	7
<b>TOTAL</b>		<b>14 (35%)</b>	<b>26 (65%)</b>	<b>40</b>

Në Universitetin e Gjilanit, përqindja e mosjustifikimit është më e lartë te profesorët asistentë se sa te profesorët e asocuar. 67% e profesorëve asistentë nuk justifikojnë titujt, përderisa 60% e profesorëve të asocuar nuk justifikojnë titujt e tyre.

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Gjilanit	Profesorë asistentë		Profesorë të asocuar	
		✓	✗	✓	✗
1	Fakulteti Ekonomik	5	5	1	3
2	Fakulteti i Edukimit	2	4	1	2
3	Fakulteti Juridik	3	6	1	0
4	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	0	5	1	1
<b>TOTAL</b>		<b>10 (33%)</b>	<b>20 (67%)</b>	<b>4 (40%)</b>	<b>6 (60%)</b>

## KRAHASIMI ME UNIVERSITETET E TJERA PUBLIKE

Në vitin 2021, 53% e profesorëve në Universitetin e Gjilanit nuk kanë asnjë punim shkencor. Për vitin 2020, përqindja e profesorëve pa asnjë punim në Universitetin e Mitrovicës është 32%, në Universitetin e Gjakovës 54%, dhe në Universitetin e Prishtinës është 29%, njëherit përqindja më e ulët në këtë kategori statistikore ndër të gjitha universitetet publike. Ndërkohë për vitin 2019, në Universitetin e Prizrenit 55% e profesorëve nuk kanë asnjë punim shkencor, si dhe 66% e profesorëve të Universitetit të Pejës nuk kanë botuar asnjë punim shkencor.

Në vitin 2021, 65% e profesorëve në Universitetin e Gjilanit nuk justifikojnë titujt e tyre akademikë. Ndërsa të dhënat e fundit në vitin 2020 tregojnë se, përqindja e mosjustifikimit të titujve akademikë në Universitetin e Mitrovicës është 48%, në Universitetin e Gjakovës është 65%, përderisa në Universitetin e Prishtinës është 45%, që rezulton të jetë mosjustifikimi i titujve akademikë më i ulët ndër universitetet publike në vend. Nga të dhënat e vitit 2019 del se, 64% e profesorëve në Universitetin e Prizrenit nuk i justifikojnë titujt akademikë, përderisa për të njëjtën periudhë mosjustifikimi i titujve në Universitetin e Pejës është 70%.

Në vitin 2021, në Universitetin e Gjilanit, 35% e profesorëve rezultojnë të kenë publikuar në revista të dyshimta. Sa i përket përqindjes së profesorëve që kanë publikuar në revista të dyshimta për vitin 2020 në Universitetin e Mitrovicës është 78%, ndërkohë që në Universitetin e Prishtinës është 38%, si dhe në Universitetin e Gjakovës është 58%. Në vitin 2019, në Universitetin e Prizrenit 66% e profesorëve kanë publikuar në revista të dyshimta, si dhe në Universitetin e Pejës 45% e profesorëve kanë publikuar në revista të dyshimta.

Universiteti	Përqindja e profesorëve pa asnjë punim	Përqindja e mosjustifikimit të titujve	Përqindja e profesorëve që kanë publikuar në revista të dyshimta
Universiteti i Gjilanit*	53%	65%	35%
Universiteti i Mitrovicës**	32%	48%	78%
Universiteti i Prishtinës**	29%	45%	38%
Universiteti i Gjakovës**	54%	65%	58%
Universiteti i Prizrenit***	55%	64%	66%
Universiteti i Pejës***	66%	70%	45%

#### Sqarim i fusnotave:

\* Të dhënat për vitin 2021

\*\* Të dhënat për vitin 2020

\*\*\* Të dhënat për vitin 2019

# FAKULTETI JURIDIK




**10** profesorë me tituj akademikë  
**Asnjë (0)** profesor i rregullt  
**1** profesor i asocuar  
**9** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR

Profesorët e Fakultetit Juridik gjithsej kanë publikuar 15 punime në revista shkencore, prej të cilave 17 janë të vlefshme për avancim akademik, që nënkupton si autor i parë dhe korrespondent. Kjo nënkupton që në ndonjë punim mund të jenë autor i parë dhe korrespondent dy profesorë nga universiteti, dhe rrjedhimisht numërohet dy herë sipas rregullativave në fuqi.


6 profesorë nga ky fakultet nuk kanë asnjë punim të publikuar si autor i parë ose korrespondent.

### PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN JURIDIK



Nga ky fakultet 2 profesorë kanë publikuar në revista të dyshimta me gjithsej 6 punime, ku vetëm në vitin 2015 janë botuar 3 punime të tilla. Nga viti 2018 nuk ka botime në revista të dyshimta.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA NË FAKULTETIN JURIDIK



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Nga 10 profesorë, 6 apo 60% prej tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë, sa i përket kriterëve ligjore për publikime në revista shkencore si autor i parë ose korrespondent.

Ky fakultet ka vetëm 1 profesor të asocuar, që justifikon titullin akademik. Kurse nga gjithsej 9 profesorë asistentë, 6 prej tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë.

### JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Profesorë asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖
3	6	1	0	n/a	n/a	4 (40%)	6 (60%)

# FAKULTETI EKONOMIK




**14** profesorë me tituj akademikë  
**Asnjë (0)** profesor i rregullt  
**4** profesorë të asocuar  
**10** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR


Profesorët në Fakultetin Ekonomik kanë publikuar në total 25 punime në revista shkencore. Kurse të vlefshme për avancim akademik janë 19, pra si autor i parë ose korrespondent. Në vitin 2017 janë botuar më së shumti punime me gjithsej 7 sosh. 5 profesorë në këtë fakultet nuk kanë asnjë punim të publikuar si autor i parë apo korrespondent.

### PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN EKONOMIK



5 profesorë kanë publikuar në revista të dyshimta, prej të cilëve 2 janë profesorë të asocuar dhe 3 profesorë asistentë. Numri total i punimeve të botuara në revista të dyshimta është 10, ku më së shumti punime të tilla janë botuar në vitin 2017. Në vitet në vijim kryesisht ka rënie, dhe që atëherë janë botuar vetëm 2.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA NË FAKULTETIN EKONOMIK



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Nga 14 profesorë të Fakultetit Ekonomik, 8 apo 57% prej tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë siç përcaktohet në bazë të kritereve për publikime në revista shkencore si autori i parë ose korrespondent.

Nga 4 profesorë të asocuar, 3 nuk i justifikojnë titujt akademikë, kurse nga gjithsej 10 profesorë asistentë 5 prej tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë.

### JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Profesorë asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖
5	5	1	3	n/a	n/a	6 (43%)	8 (57%)

# FAKULTETI I EDUKIMIT




9 profesorë me tituj akademikë  
**Asnjë (0)** profesor i rregullt  
3 profesorë të asocuar  
6 profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR

Në Fakultetin e Edukimit, stafi i rregullt akademik kanë publikuar gjithsej 13 punime në revista shkencore, që të gjitha të vlefshme për avancim akademik, që nënkupton si autor i parë dhe korrespondent. Përderisa 4 profesorë në këtë fakultet nuk kanë të publikuar asnjë punim.


### PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN E EDUKIMIT





4 profesorë kanë publikuar 9 herë në revista të dyshimta. Në vitin 2014 dhe 2015 janë botuar më së shumti punime në revista të dyshimta, përkatësisht nga 3 sosh. Në vitet në vijim trendi i botimeve në revista të dyshimta ka pësuar rënie, me asnjë publikim në revista të dyshimta në vitet 2020 dhe 2021.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA NË FAKULTETIN E EDUKIMIT



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Prej 9 profesorëve, 6 apo 67% nuk i justifikojnë titujt akademikë, në bazë të kriterëve të parapara për publikime në revista shkencore si autor i parë dhe korrespondent.

Nga 3 profesorë të asocuar, 2 prej tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë, kurse nga 6 profesorë asistentë 4 prej tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë.

### JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Profesorë asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
2	4	1	2	n/a	n/a	3 (33%)	6 (67%)

# FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE




7 profesorë me tituj akademikë  
**Asnjë (0)** profesor i rregullt  
2 profesorë të asocuar  
5 profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR

Në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, gjithsej 7 profesorë kanë publikuar 4 punime shkencore, prej të cilave që të gjitha janë të vlefshme për avancim akademik, pra si autor i parë dhe korrespondent.


Vlen të specifikohet fakti që 6 profesorë nuk kanë të publikuar asnjë punim.

### PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN E SHKENCAVE KOMPJUTERIKE



3 profesorë kanë botuar në revista të dyshimta me gjithsej 8 punime. Në vitin 2014 janë botuar më së shumti punime në revista të dyshimta, në total 4. Në vitet në vijim numri i botimeve në revista të tilla shënoi rënie, me asnjë punim në revista të dyshimta që nga viti 2016.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA NË FAKULTETIN E SHKENCAVE KOMPJUTERIKE



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Nga 7 profesorë, 6 apo 86% nuk i justifikojnë titujt akademikë, në bazë të kriterëve të parapara për publikime në revista shkencore si autor i parë dhe korrespondent.

Nga 2 profesorë të asocuar, 1 profesorë nuk e justifikon titullin akademikë, kurse nga 5 profesorë asistentë, që të gjithë nuk i justifikojnë titujt akademikë.

### JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Profesorë asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖
0	5	1	1	n/a	n/a	1 (14%)	6 (86%)

# METODOLOGJIA

## BAZA LIGJORE

- ① Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës<sup>5</sup>
- ② Statuti i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan, gjegjësisht Nenet 170, 171, 172<sup>6</sup>
- ③ Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension<sup>7</sup>
- ④ Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi –I- MASHT) 7/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension.<sup>8</sup>
- ⑤ Rregullore për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në Universitetin e Gjiilanit “Kadri Zeka”<sup>9</sup>

ORCA ka bërë shqyrtimin e publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare, të përcaktuara si kriter nga Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, Statutin e Universitetit të Gjiilanit për zgjedhje në njërin nga titujt akademikë: profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt, Udhëzimet Administrative 01/2018 dhe 07/2018, si dhe Rregullorja për përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në Universitetin e Gjiilanit “Kadri Zeka”.

5 Ligji për arsimin e lartë, 2011, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2761>

6 Statuti i Universitetit të Gjiilanit, 2020, linku: <https://ëëë.uni-gjilan.net/ëp-content/uploads/2020/12/STATU-TI-I-UNIVERSITETIT-%E2%80%9DKADRI-ZEKA%E2%80%9D-N%C3%8B-GJILAN.pdf>

7 Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, 2018, linku: <http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/01/ua-nr-01-2018-parimet-e-njohjes-se-platoformave-dhe-revistave-nderkombetare-me-recension.pdf>

8 Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi –I- MASHT) 7/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, 2018, linku: [http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/ua-7-2018-per-plotesimin-dhe-precizimin-e-ua-parimet-e-njohjes-per-revistat-nderkombetare\\_1.pdf](http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/ua-7-2018-per-plotesimin-dhe-precizimin-e-ua-parimet-e-njohjes-per-revistat-nderkombetare_1.pdf)

9 Rregullore për procedurat përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në Universitetin e Gjiilanit”, 2020, linku: <https://ëëë.uni-gjilan.net/ëp-content/uploads/2020/06/Rregullore-p%C3%ABr-procedurat-p%C3%ABrzgjedh%C3%ABse-lidhur-me-em%C3%ABrimin-riem%C3%ABrimin-dhe-avancimin-e-personelit-akademik-n%C3%AB-Universitetin-publik-Kadri-Zeka-Gjilan-2.pdf?fbclid=IëAR3X1tchtGPIf2OZst9UUu94tëyX-FK4V9GKttPK9hUpOXo0z3rX9ssqZATY>

## OBJEKTI I SHQYRTIMIT

Janë shqyrtuar CV-të e 40 anëtarëve të stafit profesorial në 4 fakultete të Universitetit të Gjilanit, duke përfshirë këtu Fakultetin e Shkencave Aplikative, ku profesorët janë të angazhuar nga fakultetet tjera. Këtu nuk përfshihen asistentët, ligjëruesit, lektorët dhe bashkëpunëtorët e tjerë të cilët nuk i kanë titujt akademikë profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt. Përveç CV-ve janë shqyrtuar edhe listat e publikimeve shkencore për secilin fakultet dhe profesor, të vendosura në uebfaqen e universitetit. Për arsye të natyrës specifike të tyre, ORCA nuk e ka bërë shqyrtimin e punimeve artistike të cilat kërkohen si kusht ekuivalent i publikimeve shkencore për profesorë nga lëmia e artit. Rrjedhimisht, këta profesorë nuk janë pjesë e këtij raporti.

## PERIUDHA E MBLEDHJES SË MATERIALIT PËR HULUMTIM

Për realizimin e këtij hulumtimi janë shqyrtuar të gjitha CV-të e profesorëve të publikuara në uebfaqe zyrtare të Universitetit të Gjilanit. I gjithë hulumtimi ka përfunduar përgjatë muajit maj 2021. Brenda kësaj periudhe, hulumtimi i CV-ve është rishikuar dhe rivlerësuar nga stafi kompetent i ORCA-s për hulumtim. Një praktikë e tillë është bërë me qëllim që rezultatet e hulumtimit të jenë sa më të sakta.

## LLOGARITJA E JUSTIFIKIMIT TË TITUJVE AKADEMIK

Sikurse pjesa dërmuese e universiteteve publike në Kosovë, në bazë të legjislaturës mbi të cilën funksionon Universiteti i Gjilanit, në procesin e avancimit vlen autorësia e parë si dhe korrespondenca në një punim shkencor.

Për pozitën profesor asistent, kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën një punim shkencor në revista shkencore ndërkombëtare me recension, relevante sipas Statutit të Universitetit të Gjilanit, si autor të parë ose korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 1.

Për pozitën profesor të asocuar kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën tri punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare relevante, sipas Statutit të Universitetit të Gjilanit, si autor të parë ose korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 3.

Për pozitën profesor të rregullt, kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën pesë punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare relevante, sipas Statutit të Universitetit të Gjilanit, si autor të parë ose korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 5.

Duke u bazuar në UA1/2018, UA7/2018 dokumente këto cilave ju referohet dhe rregullorja për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Gjilanit "Kadri Zeka", ORCA ka vendosur koeficiente për secilin punim. Këto koeficiente janë vendosur përkatësisht sipas databazave ku janë të indeksuara revistat me koeficientet 1, 0.85 apo 0.70 apo sipas revistave të listuara në rregullativat e përmendura me koeficien 0.55

ORCA i ka barasvlerësuar me koeficient 0 punimet e publikuara në përmbledhje konferencash, raportet, projektet, librat apo kapituj librash të cilat nuk janë revista shkencore ndërkombëtare, si dhe punimet të cilat janë në proces të publikimit, apo punimet për të cilat autorët kanë marrë çfarëdo konfirmimi nga revista përkatëse, por që nuk janë publikuar.

Publikimet në revista shkencore vendore dhe të vendeve fqinje, bazuar në Udhëzimin Administrativ për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension janë barasvlerësuar me koeficient 0.

Publikimet në revista të listuara si të dyshimta apo që botuesin e kanë të listuar si të dyshimtë janë barasvlerësuar me koeficient 0 dhe janë numëruar për nevoja të këtij hulumtimi.

# LLOGARITJA E NUMRIT TË PUBLIKIMEVE SHKENCORE

Pas hulumtimit të CV-ve, publikimet shkencore të gjetura në revista sipas rregullativave të përmendura, janë krahasuar mes secilit profesor brenda fakultetit, për të eliminuar dyfishimin e tyre.

Në këtë numër janë përfshirë të gjitha punimet shkencore të botuara në revista shkencore, si dhe nga analiza e justifikimit të titujve ku janë llogaritur vetëm publikimet në të cilat profesorët e Universitetit të Gjilanit figurojnë si autorë të parë dhe korrespondent.

DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit “Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë - QAINT”. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from  
 Austrian  
Development  
Cooperation



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministërstvo za Obrazovanje, Nauku i Teknologji  
Ministry of Education, Science and Technology

